

Drejtoria e Njesise Kukës

**OPERATORI I SISTEMIT TE SHPERNDARJES SH.A,
NJËSIA KUKËS
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Nr. .Prot

Kukës më datë: . .2021

Për: Bashkimin e Operatoreve Ekonomik “**EL-POWER**” sh.p.k, me NIPT L12009008K dhe Adrese: Njesia Administrative Nr.5, Rruga Bulevardi Bajram Curri, Ndertesa Nr.130, Hyrja 3, Ap.38, 1019, TIRANE dhe “**SHAMO-CONSTRUCTION**” sh.p.k, me NIPT L01326020F dhe Adrese: Njesia Bashkiake Nr. 5, Bulevardi Bajram Curri, Godina 8/1, Kati 10, AP 37, Mbrapa Pallateve Agimi, Tirane.

Procedura e prokurimit: E hapur

Numri i referencës së procedurës: REF-83317-12-29-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

Objekti i prokurimit: “Rikonstruksion kabinash dhe rrjeti TU Tropojë”.

Fondi limit : 46,394,821 (dyzet e gjashte milion e treqind e nentdhjete e kater mije e teteqind e njezet e nje) leke pa TVSH.

Afati per kryerjen e punimeve: 3 (tre) muaj nga data e dorëzimit të shëshit.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.131, datë 31 Dhjetor 2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

➤ “**DENOLT**” sh.p.k
Emri i plotë i shoqërisë

NIPT K48021210Q
numri i NIPT-it

Vlera 40,365,136 (dyzet milion e treqind e gjashtedhjete e pese mije e njeqind e tridhjete e gjashte) Lekë pa tvsh.

Drejtoria e Njesise Kukës

- **BOE “EL-POWER”** sh.p.k, me NIPT L12009008K
- **“SHAMO-CONSTRUCTION”** sh.p.k NIPT L01326020F
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera 44,935,307.25 (dyzet e kater milion e nenteqind e tridhjetë e pese mije e treqind e shtate pike njezet e pese) Lekë pa tvsh.

(me numra dhe fjalë)

- **“Vllaznimi”** sh.p.k, me NIPT: J79602601Q
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera: Nuk ka paraqitur oferte.

(me numra dhe fjalë)

Jane skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- **“DENOLT”** sh.p.k NIPT K48021210Q
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik “Denolt” sh.p.k me numër Nipt: K48021210Q na rezulton si me poshte:

- Ne shtojcen 12, **pika 1. Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, germa a) percaktohet:**
- Ofertuesi duhet të deklarojë se:
 - a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
 - b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
 - c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
 - ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
 - d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Drejtoria e Njesise Kukës

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaraten e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Nga ana e Operatorit Ekonomik Denolt sh.p.k nuk është përmbushur ky kriter pasi nuk është paraqitur dokumentacion që është regjistruar në Qendren Kombëtare të Biznesit.

- Në shtojcën 12, **pika 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1** Per kriteret e veçanta të kualifikimit, kërkohe:

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Nga ana e Operatorit Ekonomik Denolt sh.p.k nuk është përmbushur ky kriter pasi është paraqitur dokumentacion sipas kërkesës në germen a) ku kërkohe përshkrimi i ofertes, sipas Shtojcës 1, ndërsa për pjesën tjetër të kërkesave të Autoritetit Kontraktor nuk është paraqitur asnjë dokument.

Drejtoria e Njesise Kukës

- Ne shtojcen 12, **pika 2.1 Per kapacitetin ekonomik dhe financiar, percaktohet:**
 - a) kopje të certifikuara të bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse (Administrata Tatimore) te dy viteve te fundit (2018, 2019).
 - b) Kopje të deklaratave të xhiros vjetore per tre vitet e fundit, ku xhiroja mesatare e tre viteve të mos jete me vlerë më të ulët se 40% e fondit limit.
 - c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.
 - d) Vërtetim qe konfirmon shlyerjen e taksave vendore per vitin 2018 dhe 2019 lëshuar nga Bashkia/te ku ushtron aktivitet sipas QKR-se.

Nga ana e Operatorit Ekonomik Denolt sh.p.k nuk eshte permbushu ky kriter pasi eshte paraqitur dokumentacion sipas kerkeses ne germen a) kopje të certifikuara të bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse (Administrata Tatimore) te dy viteve te fundit (2018, 2019). dhe b) Kopje të deklaratave të xhiros vjetore per tre vitet e fundit, ku xhiroja mesatare e tre viteve të mos jete me vlerë më të ulët se 40% e fondit limit, ndërsa për pjesën tjetër të kërkesave të Autoritetit Kontraktor nuk është paraqitur asnje dokument.

- Ne shtojcen 12, **pika 2.3 Per kapacitetin teknik, percaktohet:**

2.3.1.Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerese se fondit limit, që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.
Ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlere monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se 150% e fondit limit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Ne rast se punimet Jane kryer me ente publike:

Drejtoria e Njesise Kukës

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon Formularin e vleresimit sipas shtojces nr. 9 të lëshuara një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, situacionin perfundimtar, Aktin e Kolaudimit dhe kontrate/tat.

Ne rast se punimet Jane kryer me sektorin privat:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore, aktin e kolaudimit dhe situacionin perfundimtar.

Nga ana e Operatorit Ekonomik Denolt sh.p.k nuk eshte permbushu ky kriter pasi ne dokumentacionin e paraqitur punet e e kryera nuk jane te se njejtës natyre apo te ngajshme me objektin qe po prokurohet.

- Ne shtojcen 12, **pika (Kapacitetet teknike dhe profesionale), Licensa profesionale lidhur me ekzekutimin e puneve te Kontratave, percaktohet:**
- **Licensa profesionale lidhur me ekzekutimin e puneve te Kontratave**
 - **Kategoria NP-1** Punime germimi ne toke, **Klasifikimi A**
 - **Kategoria NP-3** Rikonstruksione dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada **Klasifikimi B**
 - **Kategoria NP-11** Ndertime per n/stacionet, **Klasifikimi B**
kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise)
 - **Kategoria NS-1** Punime për prishjen e ndërtimeve **Klasifikimi A**

** Ne rast te bashkimit te operatore ekonomike, Licensat profesionale duhet ti paraqese operatori ekonomik qe ka marre persiper punimet per te cilat kerkohet Licensa Profesionale.*

Nga ana e Operatorit Ekonomik Denolt sh.p.k nuk eshte permbushur ky kriter pasi nuk eshte paraqitur asnje dokument sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor.

- Ne shtojcen 12, **pika (Kapacitetet teknike dhe profesionale) germa b) Çertifikatat që duhet të paraqesin operatori ekonomik, percaktohet:**

Drejtoria e Njesise Kukës

b) Çertifikatat që duhet të paraqesin operatori ekonomik:

- ISO 9001 – 2015 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë), e perditësuar
- ISO 14001 – 2015 (për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit), e perditësuar
- OHSAS 18001 – 2007 ose ISO 45001 – 2018, (për Kushtet e Sigurisë dhe të Shëndetit të Punonjësve) e perditësuar
- ISO 50001 – 2011 (për Sistemin e Menaxhimit të Energjisë) e perditësuar.

ISO-t e mesiperme duhet të jene të vlefshme në datën e hapjes së ofertave.

Në rast të bashkimit të operatoreve ekonomike ISO duhen plotësuar nga operatorët ekonomike, sipas natyrës së punëve që marrin për sipër.

Nga ana e Operatorit Ekonomik Denolt sh.p.k nuk është përmbushur ky kriter pasi nuk është paraqitur asnjë dokument sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

- Në shtojcën 12, **pika (Kapacitetet teknike dhe profesionale) germa c) përcaktohet:**

c) Per artikullin e mëposhtem:

- **Shtylla b/a**
- **Çele 20 KV**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Autorizim të prodhuesit/ve/distributor/ve për artikujt e mesiperme. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e-mail, ueb-site, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mesiperme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera, të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista mesiperme e materialeve) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

Drejtoria e Njesise Kukës

Nga ana e Operatorit Ekonomik Denolt sh.p.k nuk eshte permbushur ky kriter pasi nuk eshte paraqitur asnje dokument sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor.

- Ne shtojcen 12, **pika (Kapacitetet teknike dhe profesionale) germa d) percaktohet:**

d) Operatori ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën 40 persona, për 12 muajt e fundit (duke marr si reference daten e hapjes se tenderit) e vertetuar kjo me:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ose nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ku te specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.
2. Listë pagesa e Kontributeve te Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore te paraqitura për periudhën më sipër.

Operatori ekonomik duhet te kete minimum 15 punonjes te pajisur me kartela personale te sigurimit teknik, te leshurara nga organe kompetente te akredituara sipas ligjit 8734 date 01.02.2001 i ndryshuar.

***Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese kartelat perkatese te sigurimit teknik (te vlefshme).**

Ne lidhje me manovratorin e makinerive te renda te paraqiten deshmite e drejtimit te leshuar nga institucioni perkatese si dhe te pajisur me kartela personale te sigurimit teknik, te leshuar nga shoqeri te akredituara sipas ligjit 8734 date 01.02.2001 i ndryshuar, per te pakten 1 (nje) manovrator si dhe te jene te perfshire ne listepagesat e shoqerise.

Nga ana e Operatorit Ekonomik Denolt sh.p.k nuk eshte permbushur ky kriter pasi nuk eshte paraqitur asnje dokument qe verteton se disponon punonjes te pajisur me kartelat personale te sigurimit teknik sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor, gjithashtu nuk eshte paraqitur dokumentacion qe verteton se disponon 1 (nje) manovrator si dhe te jene te perfshire ne listepagesat e shoqerise sipas kerkesave te AK.

- **Ne shtojcen 12, pika (Kapacitetet teknike dhe profesionale) germa e) percaktohet:**

e) Operatori Ekonomik duhet te kete te punesuar ose te kontraktuar nga jashte, nje mjek te pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, sipas parashikimeve te VKM-se nr. 692, date 13.12.2001, ndryshuar me VKM 742 date

Drejtoria e Njesise Kukës

06.11.2003

(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotesoje kete kerkese ne perqindjen e marrë në kontratën e bashkëpunimit, si dhe duke pasur ne konsiderate parashikimin e pikes 12/2 te VKM-se nr. 692, date 13.12.2001, i ndryshuar).

Nga ana e Operatorit Ekonomik Denolt sh.p.k nuk eshte permbushu ky kriter pasi Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion qe verteton se ka pjese te stafit te tij ose te kontraktuar nga jashte, nje mjek te pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, sipas parashikimeve te VKM-se nr. 692, date 13.12.2001, ndryshuar me VKM 742 date 06.11.2003

- Ne shtojcen 12, pika (Kapacitetet teknike dhe profesionale) germa f) percaktohet:
- f) Operatori ekonomik duhet te kete nje drejtues teknik te pajisur me certifikate si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune" sipas parashikimeve nr. 108, date 09.02.2011, i ndryshuar dhe VKM 312 date 05.05.2010.

Nga ana e Operatorit Ekonomik Denolt sh.p.k nuk eshte permbushu ky kriter pasi Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion qe verteton se disponon nje person te caktuar te pajisur me certifikate si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune" sipas parashikimeve nr. 108, date 09.02.2011, i ndryshuar dhe VKM 312 date 05.05.2010.

2.3.1 (Makineri Pajisje)

Operatori ekonomik duhet të paraqesë automjetet dhe makinerit (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Pershkrimi	Sasia
1	Autovinc mbi 6 ton	1 copë
2	Ekskavator me goma 0.25 m3	1 cope
3	Kambaleca per mbajtjen e barabaneve te kablllove	1 cope
4	Kamion 5-7 ton	1 cope
5	Betoniere 500 l	1 cope

Drejtoria e Njesise Kukës

6	Vibrator	2 cope
7	Terraometer per matjen e rezistences se tokezimit	1 cope

- 1- Per mjetet qe shenohen ne rregjistra publike duhet te paraqitet dokument qe verteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi) plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe per mejetet e siguruara me qira, dokumentat qe verteton rregjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit te vlefshme duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese / furnizimit e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt e ketij prokurimi.
- 2- Per paisjet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.
- 3- Per makinerite me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates shoqeruar me dokumentin qe verteton rregjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin, (te vlefshme).
- 4- Per paisjet me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per kete objekt shoqeruar me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.
- 5- Operatori ekonomik nuk duhet ti kete kapacitetet teknike te angazhuara ne kontratat te tjera dhe nuk duhet te jene te deklarurara ne procedurat te shpallura fituese (deklarate me shkrim nga Administratori i Shoqerise).

Ne zbatim te nenit 26 te VKM 914 date 29.12.2014 te ndryshuar OE/BO duhet te paraqese: Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

Nga ana e Operatorit Ekonomik Denolt sh.p.k nuk eshte permeshu ky kriter pasi Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion qe verteton se disponon makineri dhe pajisje sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor.

Drejtoria e Njesise Kukës

- “Vllaznimi” sh.p.k, me
Emri i plotë i shoqërisë

NIPT: J79602601Q
numri i NIPT-it

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik “Vllaznimi” sh.p.k me numër Nipt: J79602601Q na rezulton si me poshte:

Operatori Ekonomik ka paraqitur dokumentacion qe vërteton se ka paguar të gjitha taksat dhe tarifatat vendore pranë Bashkisë Tropojë për vitin 2019 duke plotësuar pjesërisht germen d), për kapacitetin ekonomik dhe financiar tek kriteret e veçanta të pranimit/ kualifikimit të vëndosura nga Autoriteti Kontraktor.

Sa i përket kriterëve të tjera të caktuara nga Autoriteti Kontraktor konkretisht: Kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe të gjitha kriteret e veçanta të kualifikimit (Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë; Per kapacitetin ekonomik dhe financiar dhe Per kapacitetin teknik), nuk është paraqitur asnjë dokument.

Për sa me sipër, me anë të dokumentacionit të paraqitur, operatori ekonomik nuk ka plotësuar kriteret e pranimit/kualifikimit, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE “**EL-POWER**” sh.p.k, me NIPT L12009008K dhe Adrese: Njesia Administrative Nr.5, Rruga Bulevardi Bajram Curri, Nderresa Nr.130, Hyrja 3, Ap.38, 1019, TIRANE dhe “**SHAMO-CONSTRUCTION**” sh.p.k, me NIPT L01326020F dhe Adrese: Njesia Bashkiake Nr. 5, Bulevardi Bajram Curri, Godina 8/1, Kati 10, AP 37, Mbrapa Pallateve Agimi, Tirane, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 44,935,307.25 (dyzet e kater milion e nenteqind e tridhjetë e pese mije e treqind e shtate pike njezet e pese) Lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni te lutur të paraqisni pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a, Njesia Kukës, me adrese Rr. “Islam Spahiu”, Prapa Ish Kinemase, Kati II, Kukës, prane Deges se Sherbimeve Mbeshtetese sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe procedura do të anulohet duke qenë se nuk ka ofertues të tjerë të kualifikuar për këtë procedurë prokurimi, ku do të veprohej siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Drejtoria e Njesise Kukës

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 15.02.2021

Ankesa: Nuk ka patur

Titullari i Autoritetit Kontraktor

Ing.Afrim HODA

Drejtor i Njesisë Kukës